

Fletë udhëzuese e përgjithshme

Morrat e kokës

Të dashur prindër

Në shkollë ose në kopshtin e fëmijës Tuaj te disa fëmijë janë gjetur (konstatuar) morra të kokës. Nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen edhe te fëmija Juaj të mund të gjenden morra.

Infektimi (ndotja) me morra nuk ka të bëjë fare me higjienën e keqe dhe kjo ndodh shumë shpesh. Edhe larja e përditshme e flokëve nuk mund të mbrojë ndaj një infektimi të këtillë. Bartja e morrave kryesisht bëhet përmes kontaktit të drejtpërdrejtë nga koka në kokë, përmes shkëmbimit të kësulave (kapelave), krehrave ose gjësendeve të tjera personale. Morrat nuk mund të kërcëjnë e as të fluturojnë. Infektimi me morra nëpërmjet kafshëve shtëpiake nuk është e mundshme. Edhe mundësia e bartjes së morrave përmes ujit (duke u larë në pishinë) nuk është e mundur, mirëpo qëndrimi respektivisht sjellja e fëmijëve gjatë kohës së vizitës së pishinës mund të jetë problematike. Gjësendet personale (krehtrat, peshqirët etj.) assesi nuk duhet të shkëmbehen.

Ndihmoni edhe Ju që ta pengojmë përhapjen e morrave të kokës: Kontrolloni fëmijën Tuaj rregullisht! Sa më herët që të zbulohet një rast i infektimit me morra, aq më i thjeshtë do të jetë mjekimi i tij. Lexojeni me kujdes fletën tonë udhëzuese, pa marrë parasysh se a janë shfaqur morrat e kokës edhe në familjen Tuaj.

Nëse te fëmija Juaj zbuloni morra të kokës, informojeni për këtë shkollën, kopshtin e fëmijëve, kopshtin ditor të fëmijëve e ngjashëm, si dhe prindërit e shokëve të fëmijës Tuaj. Kjo është mënyra më e mirë për ta mbrojtur familjen tuaj dhe të tjerët. Një grup punues e ka hartuar një rekomandim (këshillë) lidhur me atë se si duhet vepruar në të ardhmen në Lihtenshtajn në rast të infektimit me morra të kokës. Në këtë rekomandim angazhimi i ekipeve frontale (personat që morritin – shohin nëse dikush ka morra) luan një rol të rëndësishëm. Vënia në dispozicion dhe koordinimi i ekipeve frontale te rastet akute të infektimit me morra në kopshtet për fëmijë ose në shkolla bëhet nga drejtorja përkatëse e shkollës.

Nga aspekti mjekësor nuk është me rëndësi fakti nëse një fëmijë, a duhet të dërgohet në shtëpi menjëherë pasi të zbulohet infektimi me morra, apo pasi të mbarojë shkolla. Pasi të kryhet mjekimi i parë mjekësor, fëmija sërish mund ta ndjekë mësimin (gjithashtu edhe ushtrimet e gjimnastikës dhe të notimit).

Kjo do të thotë se, nëse një fëmijë nuk mund të mjekohet menjëherë, ai për shkaqe sigurie duhet të qëndrojë larg mësimin (ambienteve shkollore), që mos t'i rrezikojë shokët e tij të shkollës.

Vizita e hapësirave (kampeve) shkollore është e vështirë (delikate), sepse mjekimi i mëtejshëm gjatë kohës së qëndrimit në kamp (shkollë) duhet të jetë në përputhje me rekomandimin për përdorim. Kjo çështje duhet të sqarohet në mes të personelit mësimor dhe prindërve.

Po qe se keni pyetje të tjera, drejtohuni te Enti për Shëndetësi, ose te mjeku apo mjekja Juaj për fëmijë.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin Tuaj.

Amt für Gesundheit

Më e rëndësishmja në një faqe

1. **Të gjithë** mund të ndoten me morra të kokës. Bartja e tyre praktikisht bëhet vetëm përmes kontaktit të drejtpërdrejtë nga koka në kokë dhe përmes ndarjes dhe shkëmbimit të kësulave/kapelave, krehrave dhe të gjërave të tjera personale.
2. Infektimi me morra mund të evitohet (përrjashtohet) vetëm përmes një **kontrolli të përsëritur dhe të saktë** të tërë flokëve.
3. Duhet të kontrollohen vetëm ata persona, të cilët e **kruajnë kokën** ose në **rrethin** e të cilëve (klasë, kopsht fëmijësh, shoqata sportive, familje etj.) janë shfaqur morra.
4. **Lidhni flokët e gjata** tok (bisht) gjatë kohës së „rrezikshme“.
5. **Në rast se gjeni morra, lajmërojeni** menjëherë shkollën, kopshtin e fëmijëve, kopshtin ditor të fëmijëve etj. dhe prindërit e shokëve të fëmijës me të cilët luan ai.
6. Në farmaci dhe/ose në barnatore informohuni në hollësi për përdorimin e produkteve kimike, siç janë të ashtuquajturit shamponë për morra. **Të mjekohen vetëm personat, të cilët me të vërtetë kanë morra.** Gratë shtatzëna ose gratë që mëndin (që u japin gji foshnjave), foshnjat dhe fëmijët e vegjël, personat të cilët vuajnë nga sëmundjet apo dëmtimet e lëkurës së kokës, personat që vuajnë nga alergjia, astma, epilepsia ose nga **sëmundje** të tjera, para përdorimit duhet të konsultohen me mjekun. **Mos zbatoni mjekim preventiv.**
7. Lexojeni tërë shtojcën e paketimit. **Gjatë shpëlarjes së produktit** mbajeni kokën përpara mbi skajin e vaskës ose lavamanit; me këtë do ta shmangni marrjen (kontaktin) e panevojshme të shamponit për morra në pjesë të tjera të trupit. Sytë mbuloni me një leckë dhe produktin special përdoreni vetëm në hapësira mirë të ajrosura. Gjatë kohës së përdorimit mbani doreza gome.
8. **Duhet të largohen të gjitha thërijat (vezët); kjo garanton një mjekim komplet.** Për këtë qëllim, pas mjekimit me shampon kundër morrave, përdorni një krehër special për thërija. Përmes mjekimit në fakt mbyten morrat, por jo edhe thërijat. Prandaj përdorimi i preparatit duhet të **përsëritet sipas informacioneve në shtojcën e paketimit.** (Shiko fletën udhëzuese „Këshillë për mjekim“)
9. **Pastroni ndërresat e krevatit, rrobat, mobiljet me shilte, lodrat e fëmijëve etj:** Sendet e përdorura dhe të cilat mund të lahen, lajini në temperaturë prej 60°C. Të gjitha sendet e tjera pastrojini me fshesë elektrike (pluhurthithëse) ose ato mos i përdorni brenda 3 ditëve.
10. **Krehrat, brushat dhe pajisjet e tjera për flokë:** Futini këto për 10 minuta në ujë të nxehtë (jo të vluar). Është e dobishme që këto gjëra t'i posedojë çdo person në amvisërinë e tij.

Largimi (mënjanimi) i thërijave dhe i morrave me një krehër të mirë për thërija, pa dyshim është një pjesë e rëndësishme e mjekimit!
(Shiko fletën udhëzuese „Këshillë për mjekim“)

Kontrollet e rregullta janë masa më të mira parandaluese!